REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA KLINË
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA
01 Nr.No.Br. 06- 9437/21
Data-Date-Datum 22,03,2021
Klinë-Klina

# RAPORT

# I PUNËS SË EKZEKUTIVIT PËR VITIN 2020

KLINË, JANAR 2021

**PËRMBLEDHJE**

Në mbështetje të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Planit të punës për vitin 2020, kam nderin që të paraqes raportin njëvjeçar të punës për periudhën 01 janar-31 dhjetor 2020, i cili përfshinë punën njëvjeçare, të arriturat e Komunës dhe vështirësitë me të cilat jemi ballafaquar gjatë vitit 2020.

Viti 2020 karakterizohet si viti me sfida shumë të mëdha, si vit i vështirë, kur në mesin tonë është paraqitur edhe pandemia Covid-19, por pavarësisht kësaj për ekzekutivin është një vit i realizimit të synimeve dhe objektivave të planifikuara sipas ligjeve aplikative në fuqi, në përputhje me Strategjinë zhvillimore dhe aktet e tjera valide për zhvillimin dhe funksionimin më të mirë për komunën tonë.

Gjatë vitit 2020 komuna ka pasur qëllimin e arritjes së këtyre objektivave:

- administratë publike funksionale në shërbim të qytetarëve;
- hapje e komunës ndaj qytetarëve;
- avancimi i së drejtës për informim;
- pjesëmarrje aktive e qytetarëve në vendimmarrje;
- ruajtja e hapësirave publike;
- avancimi i masave kundër ndotjes së ambientit;
- mbrojtja e lumenjve dhe parqeve;
- ngritja e kapaciteteve në infrastrukturë;
- zhvillimi i bizneseve të vogla e të mesme dhe joshja e tyre për investime të reja;
- rritja e prodhimeve vendore dhe subvencionimi në bujqësi;
- ngritja e treguesve të cilësisë në shëndetësi, arsim, kulturë, rini e sport;
- qasja në dokumente zyrtare;
- llogaridhënia e zyrtarëve ndaj qytetarëve si punë dhe aktivitete të tjera profesionale që dalin nga plani i punës së vitit 2019 dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi,
- Funksionim efikas të masave preventive për tejkalim të epidemisë Covid 19 në komunën tonë si çështje më primare gjatë viti 2020.
- Realizim të të gjitha projekteve të planifikuara etj.

# DREJTORIA E ADMINISTRATËS

## PËRMBLEDHJE

Raportin vjetor të punës për periudhën 1 janar 31- dhjetor 2020, i cili përmban punën dhe aktivitetet njëvjeçare, drejtorisë së Administratës dhe njëkohësisht vështirësitë më të cilat jemi përballur gjatë vitit 2020.

Viti 2020 karakterizohet për Administratën komunale si vit me vështirësi të jashtëzakonshme, jemi ballafaqua me pandeminë Covid-19 në mars-2020.

Megjithë vështirësitë me angazhim është arritë të realizohen synimet dhe objektivat e parapara sipas Ligjeve aplikative në fuqi, duke shënuar shumë të arritura dhe angazhime të Administratës Komunale, më qellim që të arrihen kushte sa më të mira për qytetarët e kësaj komune.

Administrata komunale gjatë periudhës 2020 ishte funksionale dhe efikase në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe profesionale të qytetarëve, në riorganizimin profesional dhe reformimin krahas reformës së administratës publike, punën transparente më media, OJQ shoqëri civile, duke ofruar qasje në dokumentet zyrtare, duke demonstruar qeverisje transparente dhe komunikim dhe qasje transparente me qytetarët.

Gjatë vitit 2020, komuna ka pasur qëllim të arritjes së këtyre objektivave:

- Administratë publike në shërbim të qytetarëve,
- Hapje e komunës për qytetarët,

- E drejta për t'u informuar, e cila është e drejtë e garantuar me ligj, e cila në komunën e Klinës zbatohet dhe respektohet,
- Kthimi i besimit të qytetarët në institucionet publike përmes transparencës dhe qasjes së lehtë në shërbime komunale,
- Qytetarët të bëhen pjesë aktive e vendimeve të komunës,
- Klina me Platformë digjitale për pjesëmarrje me publikun,
- Lajmërimi nga qytetarët për parregullsitë në çdo kohë dhe në çdo vend,
- Qasja në dokumentet zyrtare,

Prandaj, në pajtim të plotë me planin e veprimit për vitin 2020, besojmë që të gjitha obligimet që dalin nga këto plane dhe në përputhshmëri të plotë me Ligjet aplikative në fuqi do t'i përmbushim edhe në vitin 2021.

## DREJTORIA E ADMINISTRATËS

*Drejtoria e Administratës për vitit 2020 ka realizuar punët sipas Planit të punës së Drejtorisë, duke ofruar shërbime për qytetarët, nga të gjitha zyrat me të cilat administron, të specifikuara si me poshtë, janë kryer punët si në vijim:*

### *1. SEKTORI I GJENDJES CIVILE DHE REGJISTRIMIT*

*Nga Sektori i gjendjes civile dhe regjistrimit, në periudhën raportuese janë bërë 899 regjistrime të ndryshme: lindjes, martesë dhe vdekjes; janë lëshuar gjithsej 29.388 lloje të certifikatave dhe akte tjera:*

- *Aplikacione për humbje të shtetësisë, 88;*
- *Taksa administrative, 24.727.00€.*
- *Aktvendimet për regjistrim të mëvonshëm, korrigjime, 108*

*Ndërsa nga Kioska e vendosur para Komune janë kryer gjithsej shërbime:*

- *Certifikata të lëshuara 1241;*
- *Taksa të inkasuar 1.844.00 €.*

*Janë inkasuar taksë administrative nga Sektori i gjendjes civile gjithsej 26.571,00 €.*

*Investimet Kapital për vitin 2020*

- *Ndërtimi i ofiqarisë në Ujmirë*
- *Rinovimi i Zyrës pritëse, dixhitalizimi*
- *Rinovimi i objektit të Komunës- nyejt sanitare dhe të tjera*

## 2. *ZYRA E PROKURIMIT*

*Puna e Zyrës së prokurimit e themeluar në baze të LPP dhe Organogramit të Komunës. Punën e vet e kryen bazuar te LPP 04/L-042 dhe rregulloreve në fuqi mbi Prokurimin publik dhe Ligjin mbi menaxhimin e financave publike.*

*Zyra në afatin ligjor ka bërë planifikimin e PP, i cili është miratuar në Kuvendin komunal dhe është dorëzuar në APP .*

*Në vitin 2020 kemi iniciuar 89 procedura të prokurimit,*

*Vlera e tërësishme e buxhetit është 2.343.825.00 € .*

*Siç parashihet në nenin 9 të LPP është bërë planifikimi i prokurimit dhe i njëjti në bazë të kërkesave të drejtorive është miratuar edhe nga asambleja Komunale që në bazë të llojit janë:*

1. *Furnizime 14 procedura apo 15.73%*
2. *Shërbime 20 procedura apo 22.47%*
3. *Punë 55 procedura apo 61.80%*

### *3. Zyra Ligjore*

Si në periudhat e viteve të mëparshme edhe gjatë vitit 2020 Zyra Ligjore dhe e përfaqësimit, në bazë të ligjit dhe rregullativës tjera ligjore ka kryer dhe përmbushur të gjitha detyrat dhe përgjegjësit që i ka pasur në kompetencën e saj.

Në kuadër të kompetencës së saj zyra ka kryer përfaqësimin e komunës në të gjitha shkallët e gjyqësorit në nivel vendi, duke përfshi tërë aktivitetin e përgjegjësisë së përfaqësimit gjegjësisht avokaturës shtetërore.

Përveç përgjegjësisë së lartcekur Zyra ligjore ishte edhe pjesë e të gjitha debateve dhe takimeve tjera me publikun që ishin mbajt gjatë periudhës raportuese. Zyra po ashtu ishte pjesë e të gjitha seancave të Komiteteve komunale, e posaçërisht të kuvendit të komunës.

Më poshtë këtij raporti paraqitet tabelari i lëndëve gjyqësore të aktualizuara gjatë vitit 2020 si dhe më tutje edhe tabelari i seancave të mbajtura gjyqësore gjatë periudhës raportuese.

**Tabelari dhe komparacioni i lëndëve gjyqësore të aktualizuara-paraqitura gjatë vitit 2020, në raport me të njëjtën periudhë të vitit 2019**

---

**I.** **II.**

| Gjithsej numri i lendeve në tërë vitin 2020 (Janar-dhjetor) | Vërejtje |
| --- | --- |
| **42** | Të gjitha lëndët e tilla janë në procedurë e e sipër te gjykatat kompetente. |

| Gjithsej numri i lendeve në vitin 2019 (Janar-dhjetor) | Vërejtje |
| --- | --- |
| **38** | Të gjitha lëndët e tilla janë në procedurën e sipër te gjykatat kompetente. |

Siç shihet nga krahasimet e periudhave raportuese, në vitin 2020 ishin aktualizuar gjithsej **41 lëndë të reja gjyqësore** përderisa që ai numër i lëndëve në vitin 2019 ishte gjithsej **38 lëndë**. Nga kjo pasqyrë shihet se numri i lëndëve në vitin 2020 ishte më i madh për **4** lëndë. Po ashtu më poshtë mund të shihet numri i seancave të mbajtura nga gjykata.

Krejt ato lëndë kishin pasur kërkesëpadit e natyrave të ndryshme juridike sidomos Kërkesëpadi civile-kontestimore si: Vërtetim pronësie, pastaj nga lëmija e marrëdhënies së punës, e drejta e shfrytëzimit të tokës komunale-trojet ndërtimore, borxhet përkatëse financiare të komunës ndaj subjekteve të tjera dhe e kundërta si dhe lendë të tjera.

Sa i përket shqyrtimeve gjyqësore dhe seancave gjyqësore të mbajtura, gjykatat e vendit gjatë tërë vitit 2020 janë mbajtur gjithsej **135 seanca të shqyrtimeve gjyqësore** duke përfshirë ato përgatitore dhe ato të rregullta. Në krahasim me vitin paraprak 2020 që ishin mbajt **213** seanca gjyqësore del diferenca që në vitin 2020 ishin mbajtur më pak **78** seanca.

Zyra ligjore dhe Përfaqësimit si në të gjitha vitet e mëparshme ka përfaqësuar komunën edhe në të gjitha nivelet ministrore sa i përket përfaqësimit të lendeve konkrete administrative, ku ka lind nevoja, po edhe të këshillimeve përkatëse për të gjitha çeshtjet juridike. Në ketë drejtim zyra ka marr pjesë në disa takime online si dhe disa me prezence fizike të organizuara nga Asociacioni i Komunave të Kosovës që kanë të bejnë me zyrtaret ligjor. Kjo është me rëndësi të ceket se në ato takime behën përpjekjet e unifikimit të veprimeve dhe të gjitha procedurave ligjore në nivel vendi.

Zyra Ligjore po ashtu në kuadër të kompetencave të veta gjatë tërë viti 2020 ka lëshuar edhe akte të tjera juridike, si për Zyrën e Kryetarit të Komunës po ashtu edhe për tërë Ekzekutivin komunal, si: vendime, Urdhëresa, Pëlqime, ka hartuar marrëveshje të ndryshme, Autorizime, Konkluzione e shkresa dhe akte të tjera të cilat radhitën si në vijim:

445 vendime; 11 njoftime; 20 kërkesa; 6 autorizime; 13 pëlqime; 12 marrëveshje; 4 përgjigje; 2 letër zotime, 2 Urdhëresë, 4 mendime juridike, 3 parashtresa.

Për të gjitha kërkesat dhe aktet tjera zyrtare të cilat janë futur në shërbimin e intranetit te Zyra e Kryetarit si te Zyra Ligjore dhe Përfaqësimit i është ndërruar statusi i lendeve ashtu sipas vendosjes së tyre nga organet kompetente.

Në kuadër të aktiviteteve tjera ligjore zyra po ashtu ka ofruar të gjitha këshillat e nevojshme dhe të kërkuara nga strukturat tjera të administratës komunale.

Për përfundim mund të konkludojmë se Zyra Ligjore e Përfaqësimit gjatë vitit 2020 ka pasur një aktivitet më të shtuar në përmbushjen e kompetencave ligjore të saja në respektim të ligjit.

## *4.SHËRBIMI PËR PUNË TË KUVENDIT*

*Shërbimi për punë të Kuvendit për vitit 2020 ka përgatitur materialin për 9 seanca të rregullta, 4 seanca solemne, debate me publikun lidhur me shqyrtimin e Projekt- rregulloreve komunale,5 Seanca të jashtëzakonshme dhe një seancë urgjente e Kuvendit. 4 takime, janë miratuar gjithsej 53 vendime dhe 4 rregullore të KK Klinës, janë shqyrtuar dhe miratuar 5 raporte financiare, të gjitha vendimet dhe rregulloret janë dërguar për konfirmim të ligjshmërisë në afat të caktuar në MAPL.*

*Komiteti për Politikë e Financa ka mbajtur 9 takime.*

*Komiteti për Komunitete 9 takime*

*Komiteti për shëndetësi 1 takim*

*Komiteti për shërbime publike 3 takime*

*Komiteti për bujqësi 2 takime*

*Komiteti çështje emergjente 1 takime*

*Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi (KKSB), 2 takime.*

*Takime me qytetarët – Kryetari ka mbajtur 4 takime.*

*Nga Shërbimi – lektori, janë kryer punët rreth lekturimit të gjitha akteve të lëshuara dhe aprovuara nga Ekzekutivi dhe Legjislativi, si dhe janë mbajtur procesverbalet e mbledhjeve.*

## *5. ZYRA PRITËSE-ARKIVA*

*1. Drejtoria e Administratës, gjithsej lëndë të regjistruara, 1069*

| | |
|---|---|
| *2. Drejtoria për Shën. dhe Mirëq. Soc., gjithsej lëndë të regjistruara,* | *125* |
| *3. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, gjithsej lëndë të regjistruara,* | *278* |
| *4. Drejtoria për Kadastër dhe Gjeod. , gjithsej lëndë të regjistruara,* | *335* |
| *5 Drejtoria për Financa, gjithsej taksë te inkasuar* | *482* |
| *6.Drejtoria e Arsimit, gjithsej lëndë të regjistruara,* | *1345* |
| *7.Drejtoria e Bujqësisë, gjithsej lëndë të regjistruara,* | *1762* |
| *8.Drejtoria e Shërbimeve Publike, gjithsej lëndë të regjistruara,* | *836* |
| *9.Drejtoria e Urbanizmit, gjithsej lëndë të regjistruara,* | *646* |
| *10.Presidenca, gjithsej lëndë të regjistruara,* | *1034* |
| *11.Asambeja, gjithsej lëndë të regjistruara,* | *219* |
| *12.Zyra Ligjore, gjithsej lëndë të regjistruara,* | *100* |
| *13.Zyra e Prokurimit, gjithsej lëndë të regjistruara,* | *341* |
| *14. Zyra për kthim dhe komunitete, gjithsej lëndë të regjistruara* | *96* |

*Vlera totale e taksave te inkasuar për vitin 2020 është 1502 €*

*Ky Sektor përpos kësaj janë regjistruar edhe vërtetuar, përshkrime dhe dorëshkrime gjatë kësaj periudhe edhe kërkesa të palëve.*

*Ky Sektor përpos kësaj që u cek më lartë në regjistrin e vërtetimeve, përshkrimeve dhe dorëshkrimeve gjatë kësaj periudhe ka lëshuar edhe vërtetime, deklarata etj., me kërkesë të klientëve . Në Librin e postës janë regjistruar dërgesa, të cilat janë dorëzuar PTK-së në Klinë.*

*Në regjistrin e postës në vend janë regjistruar shkresa të dala nga KK, të cilat janë shpërndarë në teren, të gazetave zyrtare.*

## *6. ZYRA E INFORMIMIT*

**Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publik,** në kuadër të Komunës së Klinës, i mbulon të gjitha aktivitetet që zhvillohen në Komunë si ato para pandemisë por edhe gjatë pandemisë dhe ka marrëdhënie të mira me publikun. Zyra ka siguruar informim të vazhdueshëm për të gjithë qytetarët e komunës dhe më gjerë.

Zyra për Informim Publik bashkëpunon dhe mbanë kontakte me zyrtarët komunal, informon palët e interesit. Mbështet fushatat mediale për çështjet përkatëse komunale.

Arkivon fotografi, raporte, komunikata për shtyp, etj. Zyra për informim publik, pasqyron vazhdimisht aktivitetet e zhvilluara në gjithë hapësirën komunale. Të gjitha aktivitet që zhvillohen në komunë njoftohen përmes:

Monitorit i cili gjendet në hollin e hyrjes në komunë.
Viti 2020,dallon nga vitet tjera, shkaku i pandemisë, ku të gjitha takimet kanë kaluar online dhe ueb faqja e Komunës ka funksionuar çdo ditë edhe gjatë pandemisë, falë zyrtarëve të kësaj zyre.
Faqes së internetit, Ueb faqes, https://kk.rks-gov.net/kline/ , dhe Facebookut -"Komuna Klinë " ose Zyrës për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun.
Përcjellja e të gjitha aktiviteteve që zhvillohen brenda dhe jashtë komunës është përgjegjësi me peshë për punën e Zyrtares për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun.

Në kuadër të zyrës vepron edhe ueb faqja e komunës e krijuar që nga viti 2010. Kjo ueb faqe zyrtare u mundëson qasje më të lehtë qytetarëve në ngjarjet komunale. Postimi i vazhdueshëm i dokumenteve dhe ngjarjeve të rëndësishme, janë në interes për qytetarët e Komunës së Klinës.

Prej krijimit të ueb faqes dhe standardizimit të saj, kjo ueb faqe ka rritur interesimin e qytetarëve për përcjelljen e aktiviteteve të pushtetit lokal.

Bashkërendit veprimet në mes të zyrtarëve komunal dhe mediave, përpilon dhe mirëmban faqen zyrtare të internetit të komunës në të dy gjuhët zyrtare.

Rol të rëndësishëm në informim dhe komunikimin me qytetarët dhe opinionin e gjerë luanë edhe rrjetet sociale.

Për të siguruar bartje të shpejtë dhe efektive të informacionit zyrtar , kjo zyrë, përveç ueb faqes (ueb portalit) ka krijuar edhe profilet zyrtare në rrjetet sociale si Facebook, You tybe dhe Tëiter. Përmes këtyre profileve, qytetarëve do tu ofruar informacion në baza ditore për punën dhe zhvillimet në komunë .

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, që nga dhjetori i vitit 2011 merret me kërkesat e qytetarëve në Qasjen e Dokumenteve Publike dhe bënë raport në çdo tre muaj në Qeverinë e Kosovës si dhe raportin vjetor në fund të vitit. Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, ka takime të rregullta me Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe me zyrën e Kryeministrit .

Zyra për Informim Publik dhe Marrëdhënie me Publikun ,që nga viti 2016, ka filluar të bashkëpunoj edhe me Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ku i është caktuar përgjegjësia për publikimin e të gjitha Rregulloret Komunale të Komunës së Klinës.

## 7. Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe ZBGJ-re

Duke u bazuar në Ligjin për Barazi Gjinore, rregulloren, instrumenteve tjera ligjore që rregullojnë Barazinë Gjinore ,si dhe detyrave shtesë për të Drejtat e Njeriut në përgjithësi kemi mbajtur aktivitete të ndryshme: debate, punëtori, tryeza, fushata të ndryshme, raporte, statistika si dhe aktivitete të tjera sipas nevojës, për shkak të pandemisë të gjitha janë mbajtur me ZOOM.

Gjatë këtij viti në afatin ligjor për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë, sipas kërkesës së Agjencisë kundër korrupsionit I kam njoftuar të gjithë zyrtarët ,që ta deklarojnë pasurinë brenda afatit ligjor.

Gjithashtu kam organizuar takime vetëdijësuese për Barazi Gjinore me rastin e 8 Marsit si dhe udhëtimin zyrtar të grave të punësuara në Komunë.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, misioni në Kosovë(OSBE)ka organizuar ”Tryezë për promovimin e komuniteteve komunale vepruese dhe funksionimin e tyre”, në të cilën kam qenë e ftuar si zyrtare.

Tryeza ka pasur synim të promovoj funksionimin efikas të komiteteve komunale vepruese (KKV), të cilët shërbejnë si mekanizëm në nivelin lokal.

Me UNHCR-në dhe Fondacioni Jahjaga Forumi I Nivelit të Lartë, kemi mbajtur takim me të zhvendosurit dhe të kthyerit nga komunitetet e Komunës së Klinës.

Agjencioni për Barazi Gjinore, ka mbajtur ligjëratë me temë: ”Sa po kërcënohet Karriera e Gruas gjatë Pandemisë.”

Zyra për Qeverisje të Mirë , ka mbajtur konferencë me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar, konferenca është mbajtur online.

Gjithashtu, Ministria e Pushtetit Lokal ka mbajtur tryezë të rrumbullakët virtual me temë: ”Nëna,Gruaja dhe Dhuna”, pasi coronavirusi më shumë ka ekspozuar dhunën për gratë në përgjithësi.

Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për studime Gjinore, ka organizuar takim konsultativ të nivelit të lartë, me temë: ”Fuqizimi ekonomik si parakusht i parandalimit të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore.”

Ky takim ka qenë sugjerim për të forcuar, njohurit dhe bashkëpunimin midis akterëve, institucioneve që të na mundësojnë të luftojmë, fenomenin e dhunës në familje dhe dhunës në bazë gjinore.

## 8 Zyrtarët Komunale për Integrime Evropiane

Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian nënshkruan Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit më 27 tetor 2015, në Strasburg. Ajo më pas u miratua nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 30 tetor 2015.Në mars 2016 është miratuar nga Qeveria Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit(PKZMSA). Ky Program është dokumenti kryesor strategjik kombëtar për zbatimin e agjendës evropiane që mbulon periudhën pesëvjeçare 2016-2020 . PKZMSA është dokument ligjërisht i detyrueshëm për të gjitha Institucionet e Kosovës.

PKZMSA do të mbetet dokumenti kryesor strategjik nacional për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të të gjitha reformave të nevojshme për zbatimin e MSA-së dhe në fazat e mëpastajme të aderimit në BE.

Programi është vazhdimësi e dokumenteve paraardhëse që datojnë nga viti 2007 -atëherë ky dokument është quajtur Plani i Veprimit për Partneritet Evropian.

Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2019 – 2023 është programi i katërt me radhë për zbatimin e MSA-së ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës që nga hyrja e saj në fuqi më 1 prill 2016. Ky program ka për qëllim zbatimin e të gjitha reformave për adoptimin e acquis-së së BE-së në legjislacionin kombëtar në të gjithë kapitujt e saj. Ai zbatohet krahas Agjendës për Reforma Evropiane (ERA), e cila parasheh prioritetet e nivelit politik dhe reformat konkrete për përmbushjen e tyre, dhe si e tillë është e ndërlidhur me këtë program.

Procesi i Implementimit të Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ( përmes raportimit në MAPL për Obligimet për Komunat nga Agjenda Evropiane 2019) në Komunë koordinohet , monitorohet dhe raportohet nga Zyrtarja Komunale për Integrime Evropiane.
Statusi dhe detyrat e Zyrtarëve për Integrime Evropiane janë të përshkruara në Rregulloren nr. 08/2011 për organizimin dhe përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Integrime Evropiane.
ZKIE bashkëpunon me të gjitha nivelet në Komunë ,Nivelin Qendror si dhe sektorin joqeveritar. Monitoron-vlerëson shkallën e përmbushjes së objektivave dhe veprimeve të dala nga Agjenda Evropiane, ZKIE ka rol koordinues dhe punon raportet për shkallën e përmbushjes së objektivave dhe veprimeve nga Agjenda Evropiane.
Raportet janë periodike si dhe përmbledhëse vjetore, të cilat dërgohen në MAPL sipas dinamikës së kërkuar.

## *9. ZYRA PËR TEKNOLOGJI INFORMATIVE*

*Gjatë vitit 2020 Zyra e teknologjisë informative ka kryer këto shërbime si është përkrahur stafi i Administratës Komunale në aspektin e teknologjisë Informative duke përfshirë intervenime në pajisjet e TI-së, si kompjuterët, printerë, monitorë dhe pajisje tjera periferike për mbarëvajtjen e punëve në normalitet dhe të jenë sa ma efikas në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.*

*Renditja e shërbimeve të ofruara gjatë vitit 2020 bëhet si në vijim:*

- *Përkrahja në aspektin teknik për Shënimin e Kuvendit Komunal;*
- *Përkrahja në aspektin teknik për zyrat e gjendjes civile*

- *Përkrahja në aspektin teknik për Administratës së Komunës*
- *Bashkëpunimi me kontraktorin për mirëmbajtjen e kamerave të qytetit;*
- *Vendosja e kamerave së fazës së dytë nëpër shkolla;*
- *Implementimi i projektit për digjitalizimin dhe menaxhimin e radhës së shërbimit të gjendjes civile*
- *Koordinimi i punëve për mirëmbajtjen e kamerave të qytetit*

## *10. ZYRA E PRANIMIT TË MALLIT*

*Nga ky Sektor është kryer puna e pranimit të mallit të hyrat edhe të daljeve të materialeve shpenzuese dhe kompjuterëve, printerëve , fotokopjeve e materiale tjetër shpenzuese, gjithashtu janë kryer edhe raporte të pagesave në fre-balanc.*

## *11. Zyra e personelit*

*Gjatë vitit 2020 kjo Zyrë ka zhvilluar gjithsej:*

- *Konkurse të rregullta në Arsim ( Sekretar Shkolle) 1*
- *Konkurse me marrëveshje të veçanta 4*
- *Vendime për pushime vjetore, janë lëshuar 147*
- *Përmes Zyrës së personelit, ankesa janë zhvilluar 6*
- *Aktemërime dhe kontrata për të pranuarit janë lëshuar 23*
- *Raporte për MAPL-MAP, janë dhënë 3 gjatë vitit 2020 8*
- *Janë miratuar gjithsej 1.266 lëndë*
- *KPMK- es, përgjigjeje në ankesë 4*

## *12. SEKTORI TEKNIK – LOGJISTIKA*

*Nga ky Sektor është kryer: Ruajtja e Objektit të Komunës, organizimi i punës me palë, mirëmbajtja e pastërtisë, mirëmbajtja e ngrohjes, përcjellja e shpenzimeve të derivateve, mirëmbajta e veturave zyrtare, përcjellja e shkresave për organe dhe palët dhe punë tjera sipas nevojës.*

## *13.* NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Për periudhën raportuese për vitin 2020, sipas planit të punës te NJAB, kanë qenë të parapara 4 (katër ) auditime të cilat janë zhvilluar në disa njësi organizative – Drejtori në kuadër të Ekzekutivit të Komunës.

Këto auditime janë kryer që të gjitha në pajtueshmëri me planin e aprovuar vjetor të Njësitë e Auditimit të Brendshëm për vitin 2020, krejt kjo në bazë të nevojave reale dhe gjendjes së analizuar nga auditorët, Komiteti i Auditimit dhe menaxhimit i Komunës, që si qellim parësor kanë mbështetjen e organeve të Administratës së nivelit komunal, zhvillimin dhe fuqizimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të financave publike në komunë.

Kanë qenë të planifikuara 6 auditime në planin fillestar por që me rishikimin e tij është ulur numri i auditimeve si pasoje e Covid 19 dhe mospunës së administratës komunale nga dt.13 Mars deri me 1 Qershor 2020. Ky plan ka kaluar nëpër të gjitha fazat e diskutimit dhe aprovimit.

**Gjatë vitit 2020 nga Njësia e AB, janë realizuar auditimet dhe punët si në vijim:**

1. Drejtoria e Inspektoratit Planifikimi dhe Inspektimi i Bizneseve në vitin 2019.

2. Shërbimet kontraktuese tjera periudha 2019, Janar- Prill 2020.

3. Të hyrat vetjake nga Sektori i Gjendjes Civile në vitin 2020.

4.Shpenzimet për investime kapitale 2019.

**Nga auditimet e përfunduara për vitin 2019, gjendja statistikore e objektivave, të gjeturave dhe rekomandimeve është kjo:**

- Janë përcaktuar 12 objektiva për auditimet e përfunduara.
- Nga të cilat ishin planifikuar për vitin 2020 dhe të cilat janë përfunduar kanë dalë 38 të gjetura të cilat janë vlerësuar si rrezik për funksionim në sektorët e audituar.
- Janë dhëne 21 rekomandime , me qellim të përmirësimit të gjeturave.

**Krahas auditimeve të përfunduara nga NjAB janë kryer edhe punë tjera si:**

- Përgatitja e Planit Strategjik për Njësinë e Auditimit të Brendshëm për periudhën trevjeçare 2021- 2023.
- Përgatitja e Planit vjetor për Njësinë e Auditimit të Brendshëm për vitin 2021.
- Përgatitja e 4 Planeve të auditimit të punës për secilin auditim të veçantë, me formularët e duhur përcjellës.
- Përgatitja e raporteve 6 mujore dhe raportit vjetor të punës për NjQHAB dhe Kryetarin e Komunës.
- Përgatitja e 4 Planeve të Veprimit të Menaxhmentit për implementimin e rekomandimeve.
- Përgatitja e Orareve përcjellës të rekomandimeve për monitorim nga auditimi i brendshëm për të gjitha auditimet e përfunduara për vitin 2020.
- Mbajta e takimeve të rregullta me Komitetin e Auditimit .
- Bashkëpunimi me Auditorët e Jashtëm rreth punës së NjAB dhe ofrimi i shënimeve të cilat janë kërkuar nga ana e tyre.
- Përcjellja e trajnimeve që kanë të bëjnë me auditimin e brendshëm që është obligative për të mundur të ushtrosh punën e Auditorit dhe për vazhdimin e licencimit.
- Konsultime me menaxhmentin lidhur me auditimet.
- Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të dhënë për menaxhmentin dhe sektorët e veçanta.

- Konsultime profesionale me NjQHAB.

### *14.* Zyra për komunitete dhe kthimit

Gjendja e Sigurisë : Sa i përket gjendjes së sigurisë në Komunën e Klinës lëvizja e qytetarëve është e lire dhe në nivel të kënaqshëm , nuk ka asnjë ekses në lëvizjen e lirë të të komunitetit RAE në Komunës e Klinës.

Përveç këtyre, Zyra ka kryer punët e saj të përditshme në teren si dhe përcjelljen e gjendjes dhe nevoja të të kthyerve si dhe punët brenda Zyrës.

## DREJTORIA PËR FINANCA EKONOMI DHE ZHVILLIM

**Përmbledhje**

Në fillim të vitit 2020 gjatë hartimit të Planit të punës së Drejtorisë për financa,ekonomi dhe zhvillim kishim përcaktuar disa objektiva për ti realizuar.Prej tyre ndër me të rëndësishmet ishin:

**1.Ngritja dhe përmirësimi i inkasimit të të hyrave vetanake**

**2.Menaxhimi efikas dhe transparent i buxhetit të komunës së Klinës për vitin 2020**

**3.Përgatitja dhe hartimi i Kornizës afatmesëm të shpenzimeve buxhetore 2021-2023 dhe propozim i buxhetit për vitin 2021 dhe vlerësimet për vitin 2022 dhe 2023**

**4.Marrja e masave për përkrahjen dhe mbështetjen e bizneseve lokale të komunës së Klinës.**

Po mbi bazën e këtyre katër objektivave ,për secilin objektiv ne kishim përcaktuar një numër nënobjektivash si dhe një plan operativ të afatizuar dhe me veprime konkrete për realizimin e Planit të punës për vitin 2020 dhe tani kur po bëjmë bilancin e të arriturave ,përkatësisht Raportin e punës së Drejtorisë për vitin 2020 mund të konstatojmë se nuk kemi arritur të realizojmë një pjesë të këtyre pritjeve të cilat i kemi parashtruar me planin e punës për vitin 2020 si rezultat I ndikimit të pasojave të pandemisë së COVID-19,sidomos sa i përketë objektivit të parë dhe të katërt përkatësisht rritjes së inkasimit të të hyrave vetanake si dhe ofrimi i mbështetjes për bizneset lokale në komunën e Klinës.

1.Nëse fillojmë me objektivin e parë përkatësisht inkasimit të të hyrave vetanake të komunës si një nga burimet e rëndësishme të buxhetit komunal , gjatë fillim vitit 2020 ka vazhduar trendi i mirë i inkasimit të të hyrave vetanake sikurse edhe në vitin 2019 por duke filluar nga pjesa e parë e muajit mars e deri në fillim të qershorit gjatë kohës së mbylljes dhe masave kufizuese për shkak të Pandemisë së coronavirusit kemi patur rënje të madhe të inkasimit të të hyrave vetanake, rënje kjo që ka vazhduar në një masë më të vogël gjatë gjithë vitit. Në vijim do të prezantojmë treguesit financiar të realizimit të të hyrave vetanake gjatë tri viteve të fundit ku pasqyrohet edhe ndikimi dhe pasojat e karantinimit dhe masave kufizuese për shkak te pandemisë së COVID-19:

- **Të hyrat vetanake të komunës se Klinës në vitin 2018**
- Me donacione dhe participime 1.140.944,26 euro
- Pa donacione dhe participime 1.011.520,40 euro

- **Të hyrat vetanake të komunës së Klinës në vitin 2019**
- Me donacione dhe participime 1.163.859,33 euro
- Pa donacione dhe participime 1.144.244,10 euro

- **Të hyrat vetanake të komunës së Klinës në vitin 2020**
- Me donacione dhe participime 986,325.58 euro
- Pa donacione dhe participime 975,015.58 euro

Prej tyre:

- Të hyrat direkte që mblidhen nga komuna 789,896.88 dhe
- Të hyrat indirekte (gjobat) që nuk mblidhen nga komuna 196,428.70

Nisur nga treguesit e mësipërme shihet se sa ka qenë ndikimi i pandemisë së COVID-19 në inkasimin e të hyrave vetanake përkatësisht niveli i rënjes së të hyrave krahasuar me dy vitet paraprake ku faktikisht mund të themi se jemi më mbrapa vitit 2018 dhe 2019. Nëse krahasojmë të hyrat e realizuara përfshi gjobat e trafikut dhe gjobat e gjykatave në krahasim me planifikimin e të hyrave (986,325.58 /915,074.00), del se të hyrat janë realizuar 107 % ,ndërsa nëse krahasojmë vetëm të hyrat direkte që mblidhen nga komuna në raport me të hyrat e planifikuara (789,896.88/915,074.00), atëherë del se plani është realizuar vetëm 86%.

Ndërkaq sa i përket realizimit të të hyrave sipas departamenteve komunale mbi 50 % janë realizuar nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe gjysma tjetër nga të gjitha drejtoritë tjera së bashku.

Trendi negativ i inkasimit të të hyrave si rezultat i pandemisë vërehet edhe tek të hyrat nga Tatimi në pronë ku gjatë vitit 2020 janë inkasuar 303,262.84 euro ose 69,163.88 euro më pak se në vitin 2019.

2.Sa i përket objektivit të dytë që ka të bëj me menaxhimin e buxhetit rregullisht është monitoruar dhe analizuar ekzekutimi i buxhetit nga programet buxhetore komunale (drejtoritë komunale). Në vazhdimësi janë propozuar masa përkatëse në drejtim të përmirësimit të menaxhimit dhe transparencës në shpenzimin e buxhetit te komunës.

Drejtoritë komunale janë njoftuar rregullisht me rrjedhat dhe progresin e zbatimit të buxhetit, me vlerat e shpenzuara të buxhetit dhe vlerën e mjeteve në dispozicion .Është kërkuar nga Drejtorët e drejtorive që shpenzimi i buxhetit të jetë sa më racional, që të mos kemi tejkalime buxhetore por as tepricë mjetesh për pasojë te menaxhimit jo të mirë të mjeteve, dhe kjo në veçanti sa i përket projekteve kapitale.

Por sikurse në të gjitha fushat tjera pandemia ka ndikuar edhe sa i përket efikasitetit dhe realizimit me kohë të projekteve kapitale për shkak të vonesave të inicimit të procedurave të prokurimit.

Janë përgatitur dhe realizuar disa kërkesa për rialokim dhe transfer të mjeteve ndërmjet dhe brenda programeve buxhetore komunale me qëllim të ndarjes së mjeteve buxhetore për përballimin e pasojave të pandemisë por edhe për shfrytëzimin sa më racional të parave publike si rezultat i procedurave të tenderimit për projektet kapitale .

3. Një objektiv tjetër gjatë vitit 2020 që zhvillohet në formë të një procesi të rregullt buxhetor përkatësisht një cikli vjetor buxhetor ka qenë përgatitja dhe hartimi i Kornizës afatmesëm buxhetore 2021-2023 që ka filluar në muajin prill dhe është finalizuar në muajin qershor 2020 me aprovim nga ana e Kuvendit komunal si përgatitja dhe dorëzimi në Kuvendin Komunal i Draft buxhetit për vitin 2021 si dhe vlerësimet e hershme për vitin 2022 dhe 2023 në fillim te shtatorit dhe që është shqyrtuar dhe aprovuar në fund të muajit shtator 2020.

Procesi buxhetor është zhvilluar me muaj të tërë, përkundër gjendjes së krijuar nga pandemia, por ajo që nuk ka mundur të zhvillohet kanë qenë debatet publike me qytetarë për shkak të kufizimeve të tubimeve publike nga rekomandimet dhe masat për mbrojtje nga pandemia nga ana e Institutit të shëndetit publik. Është mbajtur vetëm një debat publik përmes platformës online i mbështetur nga projekti DEMOS-i ( **Decentralization and Municipal Support)** zviceran .

Sa i përket përgatitjes dhe raportimeve financiare, si Drejtori kemi përgatitur raporte të rregullta financiare tremujore dhe kemi raportuar në mënyrë të rregullt në Kuvendin komunal si dhe jemi në përgatitje të Raportit përfundimtar vjetor financiar për vitin 2020.

4.Lidhur me objektivin e katërt gjatë vitit 2020 është zhvilluar edhe një aktivitet në drejtim të informimit të bizneseve lidhur me mundësitë e ofruara për financim të aktiviteteve biznesore nga grantet, donacionet dhe formave tjera të përkrahjes nga ministritë përkatëse të qeverisë se Kosovës dhe Organizatave të ndryshme joqeveritare që kanë programe dhe ndajnë mjete në përkrahje të bizneseve.

Duke marrë për bazë dëmet që ka shkaktuar pandemia tek bizneset janë përgatitur disa Propozim-Vendime nga ana e Drejtorisë për lehtësimin sa do pak të pasojave të pandemisë të cilat janë materializuar në formë të Vendimeve të Kuvendit komunal: Janë liruar për tre muaj nga taksa komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste të gjitha bizneset të cilat e kanë pasur të ndaluar ushtrimin e aktivitetit ekonomik gjatë periudhës mars, prill dhe maj 2020;pastaj janë liruar nga ngarkesa për shfrytëzimin e hapësirave publike për komplet gjashtëmujorin e parë të vitit 2020 për bizneset në qytetin e Klinës (kryesisht nga fusha e

gastronomisë);janë liruar nga pagesa e qirasë për gjashtë muaj të gjithë shfrytëzuesit e lokaleve në pronësi të komunës si dhe është bërë zbritja e normës tatimore nga 0.20% në 0.15 % e tatimit në pronë për pronat industriale.

Ndër aktivitetet dhe sukseset e arritura gjatë vitit 2020 mund të përmendim edhe këto:

Kemi vazhduar me pagesën e pagave jubilare dhe pagave përcjellëse të arsimtarëve dhe profesorëve të pensionuar si obligim ligjor në bazë të kontratës kolektive të Qeverisë dhe SBASHK-ut për vitet paraprake por edhe për periudhën vijuese të cilin aktivitet e kemi përmbyllur deri në fund të vitit 2020.

Kemi filluar me pagesën e shujtave për punëtorët arsimor si dhe shërbyesit civil të Komunës por procesi do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2021.

Një numër të rekomandimeve të Raportit të auditimit të jashtëm kemi arrit t'i zbatojmë plotësisht dhe për disa të tjera jemi në proces të zbatimit të tyre.

**Aktivitetet administrative të punëve të përditshme të realizuara në Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim**

Sa i përket aspektit të angazhimeve të stafit të Drejtorisë në realizimin e punëve administrative dhe detyrave të përditshme të punës, ato janë kryer në harmoni me Ligjin për vetëqeverisje lokale, me Statutin Komunal, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive, Ligjin mbi Financat Lokale, Ligjin e tatimit në pronën e paluajtshme dhe udhëzimeve administrative nga Qeveria Republikës së Kosovës në bazë të kompetencave dhe përgjegjësive që dalin nga to dhe bazuar në Planin e punës së aprovuar nga Kuvendi Komunal për vitin 2020, siç vijon:

- Janë përgatitur dhe janë lëshuar 1150 aktvendime për biznese që operojnë në Komunën e Klinës për ushtrim të veprimtarive afariste, të cilat janë bazuar në Rregulloren Komunale Mbi Ngarkesat, Tarifat, Gjobat dhe Taksat Komunale.
- Këto aktvendime janë lëshuar në kohën e përcaktuar sipas këtyre akteve ligjore dhe nënligjore, duke i dërguar përmes postës të çdo obligues I këtyre taksave.
- Janë vendosur në procedura ligjore 95 ankesa të ushtruara nga obliguesit e këtyre taksave, duke i informuar ushtruesit e këtyre ankesave për epilogun e vendosjes së tyre,
- Janë lëshuar 15 kontrata për obliguesit e taksave komunale që nuk i kanë përmbushur obligimet, e që kanë dëshiruar që ato obligime t`i kryejnë më marrëveshje të dakurduar mes obliguesit dhe Drejtorisë përkatëse,

- Në këtë vit Drejtoria nuk ka lëshuar vërejtje më shkrim për bizneset që nuk i kanë përmbush obligimet e taksave, për shkak të gjendjes së situatës ekonomike të shkaktuar nga pandemia Covid 19.
- Në këtë vit vlen të përmendet dhe aksioni i organizuar nga Drejtori i Drejtorisë për verifikimin e të gjitha bizneseve që operojnë pa u regjistruar si biznese që është në kundërshtim me ligjet aplikative dhe se ai regjistër i konstatuar nga zyrtaret e autorizuar nga Drejtori i është dorëzuar Drejtorisë së inspektoratit dhe organeve tjera kompetente, me qellim të eliminimit të atyre bizneseve që operojnë ilegalisht në Komunën tone.
- Janë përgatitur 20 kërkesa për Përmbarim të cilat nuk janë dërguar të përmbaruesit për ekzekutim të obligimeve të pa kryera në disa vite më radhë si shkak i pandemisë.
- Në këtë vit është marr iniciative nga kjo Drejtori që të aprovoj Rregullat Për pasurinë jo financiare të cilat rregulla janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve e që kanë qenë edhe si rekomandim i auditorëve të jashtëm.
- **Në vitin 2020 janë regjistruar 110 biznese të reja,**
- Shuarje të bizneseve kanë qenë **22** biznese,
- Ndryshime në biznese **32**,
- **Marrja e Certifikatave të reja të bizneseve(ndërrime nga certifikatat 560** certifikata,
- Lëshuarja e aktvendimeve për zgjatje të orarit 8 aktvendime,
- Leje për Autotaxi **76** leje,
- Leje për itinerare të autobusëve **2** leje,

Raporte periodike tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore etj.

- Janë kryer të gjitha punët profesionale të planifikuara si regjistrimi dhe raportimi i të gjitha të hyrave në organet lokale dhe ato qendrore, zotimi i të gjitha mjeteve buxhetore, pagesa e të gjitha taksave komunale, lëshuarja e vërtetimeve për kryerje të obligimeve për qytetarët, certifikimi dhe shpenzimi i pagesave në zyrën e Thesarit, regjistrimi i pasurisë komunale në FRIBALANCE. Përgatitja e formularëve për ndryshim të pagave sipas kërkesave, tërheqja dhe menaxhimi i PTIKASH-it, si dhe shumë punë tjera profesionale sipas Planit të paraparë vjetor.

**ZYRA E TATIMIT NË PRONË**

Zyra Komunale e Tatimit në Pronë për periudhën janar-dhjetor te vitit 2020 ka përmbushur relativisht mirë obligimet dhe detyrat që dalin nga Ligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr.06/L-005 dhe Rregullores Komunale të Tatimin në Pronë.

Janë përgatitur dhe rifreskuar të dhënat për printimin e rreth 11.323 faturave të tatimpaguesve. I gjithë ky material i shtypur dhe i zarfuar, iu është shpërndarë tatimpaguesve përmes Postes së Kosovës në bazë të kontratës.

Vlera e tatimit të faturuar për vitin 2020 është 485.349. € prej tyre (411.696 € për objekte dhe 73.653€ për parcela.

Gjatë kësaj periudhe të vitit fiskal/janar-dhjetor/ 2020 nga ZKTP janë inkasuar gjithsej 303.263€, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 janë inkasuar më pak 69.164 € ose shprehur me numra relativ 81.4% ose 18.6% me pak. Kjo rënie e inkasimit është pasojë e bllokimit të ekonomisë nga pandemia për afërsisht katër muaj.

Pra, sipas të dhënave Zyra Komunale e Tatimit në pronë ka siguruar 38.4% të të hyrave direkte në Buxhetin e Komunës së Klinës.

Në vitin 2020 kjo Zyrë ka kryer edhe shumë punë tjera, lëshimi i certifikate vë( 30.600 copë) , faturave të rregullta, kartelave financiare për qytetarë, pra për persona fizik dhe persona juridik.

Janë kryer në teren regjistrime të reja të pronave (objekteve),212 ,verifikim me ndryshime te objekte dhe verifikime pa ndryshime 2169 objekte, gjithsej verifikime 2381 lëndë, sipas Nenit 15 pika 2 të Ligjit nr.06/L-005 Për tatimin në Pronën e pa lejueshme, Komuna duhet inspektuar 20% të pronave(Klina ka 11.323 tatimpagues, ndërsa ka inspektuar 2.381 prona),pra jemi në limitet të kërkuar sipas Ligjit.

Modifikime tjera; regjistrim të nr. personal, përmirësime emri, mbiemri, ndryshime të emrave të tatimpaguesve etj. gjithsej 1474 lëndë.

Janë pranuar 47 ankesa, prej tyre 42 janë aprovuar nga ZKTP, ndërsa janë refuzuar si të pa bazuara 5. Palët kanë pranuar vendimet e shkruara dhe të protokoluar për secilën ankesë. Janë shqyrtuar mbi 40 kërkesa të ndryshme.

Me poshtë janë shënimet e inkasimit për periudhën janar -dhjetor

sipas muajve, për vitet: 2011, 2012, 2013 , 2014 , 2015 , 2016 ,2017,2018, 2019,2020

| Viti | Jan. | Shk. | Mar. | Prill | maj. | Qersh. | Korr. | Gush. | Shtat. | Tet. | Nent. | Dhjet. | Gjithsej |
**Duke ushtruar kompetencat ligjore në mbikqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë nga sfera për Taksat, Tarifat dhe Ngarkesat si dhe në shqiptimin e gjobave për shkeljet e shkaktuara ligjore është inkasuar shuma prej 19.715,00€ dhe 14,8050 Euro në emër të gjobave mandatorë dhe 30 inicime për procedure ne Gjykatën për Kundërvajtje ne Klinë që krahasuar me vitin raportues paraprak kanë një shtim prej 0,16% dhe 2970 € në emër të taksës për vlerësimin e kushteve minimale higjeno-teknike të hapësirave punuese-lokaleve në të cilat ushtrohet aktivitetit ekonomik nga Inspektori Sanitar dhe Inspektori i Tregut.**

Nga personat fizik dhe ata juridik në nivel të Drejtorisë janë proceduar **347** kërkesa të ndryshme nga të cilat janë shqyrtuar dhe zgjidhur sipas procedurës së paraparë ligjore **100**,janë refuzuara si të pa bazuara – **9** , janë **12** ne procedurë **,13** në pritje .

Më qëllim të informimit të ndërsjellë në relacionin: Organet e Inspektoratit dhe Drejtoria në raport me Drejtoritë tjera dhe Kryetarin e Komunës si dhe në vijën vertikale në raport me Qeverinë dhe Ministritë gjegjëse, janë hartua informata, raporte, memorandume dhe relacione tjera zyrtare në kërkesë të tyre dhe ato sipas detyrës zyrtare.

Duke perceptuar dhe shqyrtuar aspektet dhe veprimet e sipërshënuara, pashmangshëm rrjedh konstatimi i paraqitjes edhe të vështirësive dhe pengesave tjera që shfaqen përgjatë ushtrimit të kontrollit isnepktues sidomos në numrin jo të mjaftueshëm të inspektorëve krahasuar më numrin e banorëve në komunën tonë, mosplotësimi i vendit vakant të punës së Inspektorit Sanitar, demotivimi për punë nga pasoja shpërblimit jo adekuat krahasuar me punën e tyre/përgjegjësitë, punën jashtë orarit dhe rrezikshmërinë e ushtrimit të funksionit të tyre nga shkaku i kufizimeve buxhetore.

Në vijim paraqitet në vija të shkurtra puna veç e veç e secilit Organ të Inspektoratit pa pretenduar që të shkoqiten punët dhe aktivitetet e tyre rutinore dhe në detaje e që janë të përcaktuara në fushëveprimin dhe kompetencat e tyre ligjore.

**Inspkektimet nga Lëmia Publike.-**

**Ligji Nr. 03/L-212 dhe nenit 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,** Inspektori i shërbimeve Komunale **Elmi Krasniqi** për shkak të gjendjes

shëndetësorë ( sipas qarkores zyrtare të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë e përgatitur për ketë qellim) punëtoret me sëmundje kronike dhe të ngjashme lirohet nga punëdhënësi në punë. **Inspektori Shërbimeve Publike sipas fuqisë Ligjore punët dhe detyrat punuese me autorizim të eprorit të organit në periudhën raportuese ka ushtruar Komisioni Inspektues/.-**

Në këtë lëmi në periudhën raportuese janë ushtruar mbikëqyrje inspektuese e që ka rezultuar me procesverbale të përpiluara në vend. Në objektiv të kontrollit ka qenë rrjeti i kanalizimit ,ujësjellësit, ai elektrik, i telekomunikacionit, hapësirat urbane publike, organizimi i punëve në pastrimin edhe matarimin e mbeturinave, veprimet e koordinuara me inspektoret tjerë ne aksione të përbashkëta, dalja ne vend dhe shqyrtimi-trajtimi i kërkesave të ndryshme të personave fizik dhe juridik të natyrës përkatëse, ne stinën e dimrit organizimi dhe pjesëmarrja në pastrimin dhe lirimin e rrugëve nga bora dhe punët tjera me prioritet nga fushëveprimi i tij .Në procedurën e mbikëqyrjes së hapësirave publike janë nxjerr aktvendime.

**Inspektimet nga Lëmi i Ndërtimit.-**

Në këtë resor duke ushtruar mbikqyrjen inspektuese në zbatimin e dispozitave ligjore të ndërtimit janë ushtruar 300 kontrolle duke përfshirë edhe ato monitoruese inspektuese, janë hartuar **109** procesverbale në vend dhe janë iniciuar procedure për kundërvajtje **11** , shënohen shënime zyrtare të natyrës përkatëse gjatë ushtrimit të aktivitetit mbikëqyrës, duke shtuar këtu edhe organizimin e punës në formë kujdestarie, gjatë ditëve të vikendit dhe atyre të festave të ndryshme. Po ashtu është koordinuar dhe bashkëvepruar më inspektoret tjerë në kuadër të Drejtorisë në punët e përbashkëta sidomos në kontrollin e përgjithshme për mbrojtën nga pandemia Cvid-19 , punët e tregjeve javore, transportin e kombinuesve etj. Nga ky organ janë shqiptuar gjoba në vlerë prej **13,200 €.**

**Inspektimi në Lëmin e Komunikacionit/trafikut/.-**

Ky organ në vitin raportues ka ushtruar mbikëqyrje inspektuese nga lëmi i transportit të udhëtarëve dhe mallrave, mbarëvajtja e shenjave të trafikut në rrugët rajonale dhe ato lokale, vendosja në kërkesat e palëve etj. Në lidhje me ketë janë

hartuar 7 procesverbale si dhe janë evidentuar monitorime nga sfera e qarkullimit të mjeteve të transportit të udhëtarëve si brenda lokalitetit të Klinës ashtu edhe jashtë saj përkatësisht të qendrave të lokalitetit në territorin e Komunës së Klinës. **Është asistuar në vendosjen, dhe shenjëzimin e shenjave vertikale dhe horizontale nga Kompania fituese e tenderit përkatës në qytezën e Klinës dhe jashtë saj.** Po ashtu është bashkëvepruar me organet tjera inspektuese në aksione të përbashkëta të planifikuar nga Drejtoria.

**Inspektimi nga Lëmi i Bujqësisë dhe Ambientit.-**

Gjatë periudhës raportuese nga lëmi i inspeksionit të bujqësisë dhe ambientit janë ushtruar **50** inspektime dhe po aq procesverbale mbi konstatimin e gjendjes në vend, ,7 procesverbale për mbikëqyrjen e menaxhimit të mbeturinave, në kontrollin e kualitetit të miellit që përdorin furrat e bukës, dhe11/barnatoreve bujqësore dhe fidanëve/ të tjera. Nga kjo 1 kërkesë e ushtruar për inicimin e procedurës kundërvajtje si dhe 6 gjoba të shqiptuara në vlerën prej **600 €.**

**Inspektimi në Lëminë Sanitare.-**

Në zbatim të dispozitave nga lëmi i mbikëqyrjes sanitare dhe të mbrojtjes shëndetësorë të popullatës **LIGJI NR. 07/L-006 PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E PANDEMISË COVID-19 NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS.**

Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës atij për duhanin si dhe aktet tjera të kësaj lëmie, Inspektori sanitar ka ushtruar **1200** mbikëqyrje inspektuese dhe ka përpiluar **557** procesverbale mbi konstatimin e gjendjes në vend. Inspektori Sanitar ne bashkëpunim me Stacionin Policor te Klinës dhe me inspektoret përgjegjëse bazuar ne **Ligjin Nr. 07/L-006** për parandalimin dhe luftimin e pandemisë covid-19 në territorin e Komunës se Klinës, te nxjerre vendime operacionale varësisht prej situatës epidemiologjike dhe rekomandimeve te **IKSHP-se** janë nxjerre **495 vendime** për vetëizolim .Te vdekur nga Pandemia Covid-19 janë **35** persona kryesisht te moshës mbi **60 vjet** është përcjelle ceremonia

e varrosjes ne bashkëpunim me Policinë .Janë marrur mostra të analizës së ushqimit ,Janë iniciuar procedurë për kundërvajtje ne Gjykatën Themelore – dega në Klinë 10 gjoba. Është punuar aktivisht në transmetimin dhe jetësimin e fushatës parapërgatitore në aplikimit të dispozitave ligjore të Duhanit si dhe për masat e përgjithshme dhe specifike për mbrojtën nga pandemia Covid-19 .Është punuar intenzivisht në rrjetin e objekteve hotelierë ashtu edhe në objektet shkollore private dhe publike të Komunës. Pjesëmarrja në Komisionin vlerësues të përcaktimit të kushteve minimale teknike, sanitare-higjenike dhe të tjera të lokaleve dhe bizneseve janë inkasuar ne gjoba dhe pranime teknike dhe asgjësime ne vlere prej **2945** euro. Më nismën e këtij organi dhe në bashkëveprim me Inspektoret Sanitarë të Agresionit të Ushqimit dhe Veterinës të Republikës së Kosovës , është kontrolluar aspekti i përgjithshëm, kushtet sanitaro-higjenike të subjekteve të ndryshme afariste, janë marrur strishot e të punësuarve dhe nga mjetet e punës së tyre. Po ashtu janë dhënë pëlqime në projekte të ndryshme, zhvarrosje etj, si dhe pjesëmarrje në trajnime, seminare etj, me qellim të koordinimit të aktiviteteve të përbashkëta.

**<u>Inspektimi në Lëmin e Tregut.-</u>**

Mbikëqyrja e kushteve të ushtrimit të veprimtarive ekonomike, qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve, kualiteti i produkteve industriale dhe ushqimore, cilësia e shërbimeve, verifikimi i regjistrimit /pajisja me Certifikata për Regjistrimin e biznesit/ të të gjitha subjekteve afariste tregtare dhe shërbyese, objekteve dhe subjekteve tjera, ka qenë objektiv i punës dhe aktivitetit të këtij organi e që ka ushtruar 190 kontrolle inspektuese me ç 'rast ka udhëhequr procesverbale mbi fakt imin e gjendjes në vend duke proceduar me nxjerrjen e 60 aktvendimeve përmbajtjesorë për eliminimin e të metave të konstatuara duke i vurë afatet dhe duke ushtruar kontrollet kthyese inspektuese për përmbushjen dhe përmbarimin e të njëjtëve, atë për paralajmërim për mbyllje-ndërprerje të aktivitetit biznesorë.

Duke koordinuar me Inspektorin sanitar është ushtruar kontrolli inspektues ndaj furrave të bukës për 5 raste kurse është ndërmarre masa administrative për gatim të standardizuar me etiketë të deklaruar që përmban peshën e bukës, adresën e prodhuesit, përbërjen –shtesat/aditivët/,datën e prodhimit, afatin dhe mënyrën e përdorimit dhe çmimin e shtijës sipas njësive të destinuara për shitje në treg si dhe 60 raste pjesëmarrjes në Komisionin vlerësueses për kushtet minimale

teknike, higjeno-sanitare dhe të tjera të lokalit duke nxjerrë kështu 60 aktvendime për dhënien e pëlqimeve gjegjëse ku janë inkasuar në emër të shpenzimeve komisionarë inspektues për këtë qellim **2970** euro, dhe janë iniciuar **5** procedura në **Gjykatën për Kundërvajtje** në Klinë . Në mbikëqyrjen e Rregullores për orarin e Punës së subjekteve afariste shënohen 33 mbikëqyrje dhe atë më shumë gjatë orëve të vona të natës po ashtu në bashkëveprim me PK. Në koordinim me Zyrën për biznese janë mbarshtruar dhe është punuar në zgjidhjen e kërkesave për lejimin e zgjatjes së orarit të punës së subjekteve afariste nga lëmia e hotelerisë e që është në përputhje me Rregulloren përkatëse Komunale shënohet për 9 raste. Janë hartuar 21 informata, raporte, shënimi zyrtare, sqarime dhe interpretimeve procedurave në vijën horizontale dhe vertikale.

**Në pasqyrimin e punëve dhe aktiviteteve punuese për vitin raportues nuk është përfshirë puna qoftë vetanake qoftë në bashkëveprim me Inspektoret e Tregut në kuadër të MTI-së sipas Planit të Veprimit të Inspektoratit të Tregut të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Republikës së Kosovës, kurse sipas një vije të veçante ka qenë raportimi i urdhëresës se lëshuar nga MTI-ja për verifikimin e mallrave te nxjerr nga Qeveria e Rep. Kosovës .**

Në zbatim e **Ligji Nr. 07/L-006 Për parandalimin dhe luftimin e pandemisë covid-19 në territorin e Rep. së Kosovës,** Në mbështetje të **Nenit 65 (1)** të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ne bashkëpunim me Inspektorin sanitar kemi ushtruar mbi **600** mbikëqyrje inspektuese dhe kemi përpiluar **557** procesverbale mbi konstatimin e gjendjes ne bashkëpunim me Policin e Kosovës dhe me inspektoret përgjegjëse janë marre masa ndëshkuese dhe vërejtje me shkri m duke bazuar ne **Ligjin Nr. 07/L-006** për parandalimin dhe luftimin e pandemisë covid-19 në territorin e Komunës se Klinës, te nxjerre vendime operacionale varësisht prej situatës epidemiologjike dhe rekomandimeve te **IKSHP-se**

**Inspektimi nga Lëmin financiar-Lejeve të Punës/regjistrimit/ të bizneseve.-**

Në këtë lëmi janë ushtruar **60** mbikëqyrje inspektuese kurse lidhur me to janë hartuar 48 procesverbale për konstatimin e gjendjes në vend. Janë nxjerre **10** Aktvendime e Komisionit për përcaktimin e kushteve minimale teknike-higjeno-sanitare ne shumen prej **644** euro , **3** Dënime Mandatorë në shumën prej **1.060** euro dhe **1** inicim

për procedure për Kundërvajtje ne Gjykate dhe te tjera të lokalit për biznese ku janë plotësuar urdhërpagesat për kompensim të pagesave në emër të taksës . Po ashtu është bashkëvepro me inspektoret tjerë në nivel të Drejtorisë në aksionet e koordinuara të përbashkëta dhe në monitorimin e tregjeve për 59 raste. Është udhëhequr evidenca e lëvizjes së pagesave të ndryshme në emër të taksave, ngarkesave dhe tarifave dhe kontrolli në përllogaritjen dhe orientimin e drejtë të tyre.

**PROPOZIMI I MASAVE:**

Duke konkluduar mbi konstatimet e sipërshënuara dhe efektet e arrira nga periudha raportuese, paraqitet domosdoshmëria në ndërmarrjen e masave dhe veprimeve në:

- ngritjen përkatësisht stimulimin material të inspektorëve dukë korrigjuar koeficientin në përfitimin e të ardhurava personale dhe kompozimin për punën gjatë ditëve të festave, vikendeve apo jashtë orarit të punës;
- shtimin e numrit të Inspektorëve sipas standardeve ligjore në përpjesëtim me numrin e rezidentëve/banorëve/në Komunë.-

## RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2020, I DREJTORISË PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

Drejtoria për Shërbime Publikë dhe Emergjence gjatë këtij viti është ballafaquar me shumë probleme dhe vështirësi të pa planifikuara të cilat kishin të bënin me Pandeminë e emëruar COVID – 19, e cila shkaktoj shumë probleme dhe vështirësi në realizimin e plotë të punëve të planifikuara. Mirëpo, mund të konstatojmë së ka qenë një vit shumë i suksesshëm, përkundër vështirësive të me lartpërmendura. Gjatë vitit 2020 në sektorin e shërbimeve publike nga ana e palëve janë parashtruar gjithsej: **836 kërkesa, të** cilat kanë të bëjnë kryesisht me nevojat e përgjithshme të qytetareve duke përfshi; riparimin e rrugëve me zhavorr në fshatra dhe disa rrugica neper lagje të qytetit, riparim të gropave në rrugët me asfalt, furnizim me ujë dhe riparim të ujësjellësit, riparim dhe kyçje në kanalizim, pastrimin e rrugëve nga bora,

leje për shfrytëzim të hapësirës publike, kërkesa për ndriçimin publik si dhe kërkesa për ndihmë me artikuj ushqimor veçanërisht në fillim të ballafaqimit me Pandeminë dhe materialit ndërtimor për ndërtim apo renovim të shtëpive. Varësisht nga mundësit buxhetore jemi përgjigjur kërkesave të qytetarëve. Nga ana e drejtorisë janë shqyrtuar këto kërkesa dhe gjendja është si në vijim:

- **Të miratuara 750**
- **Të refuzuara 21**
- **Në proces 44**
- **Te pranuara 12**
- **Të hedhur poshtë 1**
- **Të pezulluara 1**
- **Të anuluara 7**

**Gjithsej...........836 kërkesa**

Ndërsa sa ju përket projekteve të realizuara dhe në realizim e sipër për ketë vit, shkurtimisht po i theksojmë disa prej rezultateve të arritura për vitin 2020:

- **Dekorimi i qytetit për festat e fund vitit.** Edhe këtë vit qyteti i Klinës ishte qyteti me i dekoruar në krahasim me qytetet tjera. Përkundër ndalesave dhe orëve të kufizuara në mbrëmje, numër i madhe të qytetareve vinin edhe nga qytetet tjera, posaçërisht nga qytetet fqinje për tu kënaqur me atmosferën e krijuar për rreth 1 muaj rresht. Komuna nga Buxheti i saj harxhoj vetëm 6,995.00euro, duke ripërdorur pjesën ma të madhe të materialit dekorativ nga viti i kaluar.
- **Rregullimi i varrezave të Veteranëve dhe rrethoja në varrezave publike në fshatin Dobërdol dhe Zajm.** Përgatitjet kemi filluar në muajin Shkurt dhe Mars, ndërsa procedurat dhe përzgjedhja e kontraktorit është kryer në muajin Gusht e Shtator . Kemi bashkëpunuar edhe me përfaqësuesit e bashkësive fetare dhe përfaqësuesit e OVL UCK, duke i përfillur edhe kërkesat dhe sugjerimet e tyre. Punët janë kryer me një ritëm të ngadalshëm, me disa pengesa nga reshjet atmosferike, mirëpo projekti është realizuar me sukses.
- **Riparimi dhe mire mbajtja e rrugëve pa asfalt**. në vazhdimësi kemi kërkesa të shumta në baze ditore lidhur me riparimin e rrugëve ende të pa asfaltuara në të gjitha fshatrat dhe brenda në qytet. Deri me tani kemi intervenuar në sanimin e gropave, rrafshimin, mbushjen dhe ngjeshjen me

cilindër në **rrugë** e rrugica në fshatra dhe periferi të qytetit. Kemi shpërndarë **4460m3 zhavo**rr të fraksioneve të ndryshme për meremetimin e rrugëve lokale, ndërsa për heqjen e mbeturinave inerte kemi përdorur ekskavator të llojeve të ndryshme dhe kemi hequr 1.000m3 mbeturina inerte. Vlera e përgjithshme e Lot 2 ishte 21948.00€ ndërsa vlera e përgjithshme e kontrate LOT 1 +LOT 2 ishte 44.002.00€

- **Riparimi dhe mire mbajtja e rrugëve me asfalt /LOT 2/ e Projektit "Mirëmbajtja Verore e Rrugëve , vlera totale 44.002.00€ .** Procedurat e tenderimit kanë filluar me vonese për shkaqe tani të ditura, në muajin Qershor. Është përzgjedhur operatori ekonomik me i volitshëm sipas procedurave të prokurimit dhe Komisionit Vlerësues, mirëpo edhe operatori ekonomik nuk është treguar mjaftueshëm efikas dhe i përgjegjshëm në kryerjen e punëve në teren. Kemi dale disa here në teren duke i shënjuar rrugët dhe pjesët e dëmtuara të asfaltit në rruge, mirëpo realizimi i punimeve shtyhej për shkak të mungesës së planifikimit dhe kapaciteteve të pa mjaftueshme të O.E. i cili kishte kontraktuar pune në disa komuna duke mos i llogaritur mire kapacitet e kompanisë dhe kohen e realizimit, prandaj edhe është qortuar me vërejtje.
- **Mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit publik**. Janë ndërruar të gjitha llampat /trupat ndriçues/ të tipit të vjetër me zhive apo halogjenë me trupa ndriçues efecient. Përpos riparimit dhe ndërrimit të llambave/ trupave ndriçues/ të dëmtuar në rrugët me ndriçim publik në qytet dhe në shëtitoren përgjatë Lumit Klina, kemi instaluar linja të reja në fshatin Sferkë, Volljakë, Poterq, Gjurgjevik i Vogël, Zllakuqan dhe disa rrugë në Klinë. Gjithashtu kemi kryer intervenime në riparime të stabilimenteve e pajisjeve në shumë rrugë tjera. Kontrata është 2 vjeçare dhe arrin vlerën e përgjithshme 90,000.00€uro
- **Mirëmbajtja dhe riparimi i kamerave të qytetit.** Sipas planifikimit është bërë ç'vendosja e kabllove optike të mbetura në qendër të qytetit, respektivisht në sheshin Mujë Krasniqi nga shtyllat dhe objektet tjera, në galerinë nëntokësore dhe ndërrimi e kamerave të vjetruara me shumë së 10 vite me të reja, zgjerimi i rrjetit në parkun e ri të qytetit dhe zëvendësimi i monitorit të vjetër në sallën e vëzhgimit me 2 monitorë të rinj. Kontrata është 3 vjeçare, në vlere 30.000€uro, dhe do të zhvillohet në faza sipas viteve. në vitin 2020 janë shpenzuar; 10.000€ dhe pjesa tjetër do të realizohet sipas planifikimit për vitin në vazhdim.

- **Fondi për ndihmë Emergjente COVID -19 . në** bashkëpunim me drejtoritë tjera komunale dhe me vendim të Grupit Punues të emëruar me Vendim të Kryetarit të Komunës janë zhvilluar projekte sipas nevojës dhe kërkesave në teren. 1. Furnizim me Pako Ushqimore në vlere prej; 19,398.30.€. Projekti është menaxhuar nga Drejtoria e Financave dhe është ndare sipas listës së aprovuar nga Komisioni Komunal me përfaqësues të fshatrave dhe shoqatave. 2. Projekti i radhës ishte në Vlere prej 90,000.00€, i aprovuar nga Asambleja Komunale, e cila kishte formuar Komision të përbashkët me përfaqësues të partive politike përfaqësuese në Asamble dhe Ekzekutivit të cilët e kishin përgjegjësinë për formimin e listave të përfituesve dhe shpërndarjen e pakove ushqimore.
- **Mirëmbajtja e drunjtëve dekorativ. Në** qytet kemi rreth 400 trupa të drunjve dekorativ. Rreth 300 trupa, janë duke filluar nga sheshi "Nue Perlleshi" , sheshi " Mujë Krasniqi" , sheshi " Nena Terezë" e deri të sheshi "Faruk Elezaj". Duke qene së për 3 vite rresht kjo pjese e qytetit ishte në ndërtim për shkak të punime të tunelit dhe kalldrëmit, drunjtë kishin pësuar dëmtime të mëdha, prandaj është dashur qe në mënyre profesionale të trajtohen të gjithë këta drunjë, duke filluar nga krasitja, plehërimi, trajtimi me insekticide, instalimi i sistemit të ujitjes, punimit të tokës për rreth etj. Tani pemët kane marre forme të mire dhe të njëtrajtshme. Kane rritje të mire dhe janë të shëndetshme. Operatori Ekonomik "BYTYQI" i cili ka kontrate 3 vjeçare në vazhdimësi nuk i ka kryer punët me korrektësi të plotë sipas kërkesave të menaxherit të kontratës, prandaj edhe është qortuar me vërejtje. Punët e pa kryera janë refuzuar të paguhen dhe si pasoje e vonese në ofrimin e fletëpagesës me punët e përfunduara, pagesa në vlere prej1,296.00€, ka mbete e pa realizuar për vitin 2021. Është propozuar ndërprerja e kontratës dhe gjobitja sipas Ligjit për Prokurim Publik.
- **Mirëmbajtja dhe zgjerimi i hapësirave publike, trotuareve dhe parqeve/ dhe parking për automjete/.** Kontrata 3 vjeçare në vlere 71,300.00€uro përfshin grupin e punëtoreve prej 6 vetave, të cilët merren me pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike , trotuareve, parqeve dhe parkingjeve në qytet dhe periferi të qytetit , si dhe mirëmbajtjen e shëtitores përgjatë lumit Klina. Ky grup i vogël i punëtoreve të mirëmbajtjes janë për çdo lëvdatë dhe bëjnë pune të shkëlqyeshme. Kryepunëtori i grupit është edhe manipulues me mjete e makineri si dhe shofer i auto cisternës për furnizim emergjent me ujë dhe pastrim dhe larje të rrugëve. Gjithashtu edhe në ketë vit është vazhduar me përmirësimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe parkingjeve ekzistuese,

posaçërisht shëtitorja përgjatë lumit Klina, duke vazhduar me trendin e zgjerimit të këtyre hapësirave publike. Planifikimi për vitin 2020 ishte qe të punohen 450m2 hapësirë publike me qellim të shfrytëzimit për treg të gjelbër duke u bazuar në Vendimin e Asamblesë Komunale dhe Hartave Zonale të qytetit i cili do të vazhdoje edhe në vitin 2021.

- **Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në qytet dhe fshatra.**
  Sipas Planit Operativ Territori i Komunës së Klinës është ndare në tri pjesë. Operatori i përzgjedhur ka siguruar sasinë e mjaftueshme të kripës dhe rërës për akull, ndërsa makineria është në gatishmëri sipas kërkesave dhe kushteve të parapara me kontrate. Viti 2020/21 është viti pare i Kontratës 3 vjeçare në vlere të përgjithshme 110,583.70€uro.
- **Mirëmbajtja dhe riparimi e rrjetit të kanalizimeve.** Rrjeti i kanalizimeve në shumë fshatra e qytet po paraqet problem të madh në mirëmbajtje. Hedhja e mbeturinave në puseta dhe kyçja e stallave të bagëtive apo ujërave të shiut, shpesh shkakton defekte shumë të mëdha. Problemi me i madhe paraqitet në pjesët ku është instaluar kanalizimi , mirëpo nuk ka ende rrjet të ujësjellësit, dhe si pasoje KRU HIDRODRINI nuk e merr në mbikëqyrje për shkak së nuk e vjel tarifën e ujit të hargjuar. Prandaj, jemi në procesin e marrjes së të dhënave për nevojat e riparimit dhe mirë mbajtjes së këtij rrjeti. Ketë vit kemi investuar në riparimin e rrjetit të dëmtuar në gjashte segmente në fshatin Caravik në vlerë prej ; 17,994.16€ si dhe kemi siguruar gypat e brinjëzuar HDPE PSN 8DN, sipas kërkesës dhe marrëveshjes së bashkëpunimit me KRU HIDRODRINI ,Nj.O. në Klinë për riparimin e kanalizimit të dëmtuar në fshatin Sferkë.
- **Mirëmbajtja dhe servisimi i aparateve kundër zjarrit.** Është kontrate 3 vjeçare. Përfshin mirëmbajtjen dhe servisimin e aparateve për fikje zjarri në të gjitha objektet e Komunës së Klinës, duke përfshi edhe shkollat, çerdhet dhe objekte e gjendjes civile në Bashkësi Lokale. Vlera e përgjithshme është 10,000.00€uro.
- **Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit dhe furnizimit me ujë.** Punët e filluara vitin e kaluar i kemi vazhduar edhe ketë vit. në fshatrat; Qupevë e Lartë dhe Ultë, Volljakë, kemi investuar në sigurimin e burimit të ujit dhe instalimin e rrjetit dhe pompave, ndërsa banoret kanë investuar në ndërtimin e rezervuarit të ujit. Ky investim do të ndikoj qe në fshatin Dush dhe Sferkë, ta stabilizoje furnizimin me ujë gjate gjithë vitit,
- **Projekti për furnizim me ujë të pijshëm për terë Territorin e Komunës së Klinës;** në vitin 2019 është hartuar projekti me i rëndësishëm dhe me i kërkuar për qytetaret e Komunës së Klinës, projekti i ujit të pijshëm. Ky

projekt, pas përfundimit të studimeve të fizibilitetit të kompanisë projektuese Vizion Plus nga Prishtina, vlerëson së burimi i ujit në rrjedhën e shtratit të lumit "Drini i Bardhe " siguron 300l/s, litra ujë të pijshëm për sekondë, i cili do të jetë i mjaftueshëm për rreth 40.000banoret rezident të komunës sonë dhe rreth 20.000 banore jo rezident, të cilët kalojnë kohe të caktuar gjate vitit në vendlindje. Kompleksi do të ketë edhe pjesë rekreative, duke përfshi liqenin akumulues me gjatësi rreth 1.000metra, parkun/liqenin endemik, shëtitoren, pishina, fusha sportive etj. Kostoja e projektit sipas studimit do të arrije deri në 3.5Milion euro dhe është aprovuar në Asamblenë Komunale. Ketë vit kemi filluar me implementimin e Fazës së Pare; "Ndërtimi i Liqenit Akumulues dhe hapja e puseve për ujë të pijes në vlerë prej 34,591.11€uro. Punimet janë realizuar sipas projektit, mirëpo rezultatet e pritura nuk ishin të kënaqshme. Kemi vazhduar me Fazën e Dyte; "Ndërtimi i basenit Filtrues për shtimin e kapaciteteve të ujit në fabrikën e ujit në Klinë" – LOT 1 - Punët Ndërtimore, në vlere prej 44,725.00€uro, dhe LOT 2 -. Sistemi i filtrimit dhe stacionet e pompimit në vlere prej 58,076.00€uro.

- **Ndërtimi i Impiantit për pastrimin e ujerave të zeza dhe kanalizimit në fshatin Volljakë.** Është projekt i cili ka filluar në vitin 2019 dhe po realizohet nga CDI, me financim të Qeverise së Republikës së Kosovës dhe Qeverise së Zvicrës. Projekti në total kalon vlerën prej 300,000€uro. Është projekti i pare i këtij lloji në Komunën e Klinës. Funksionimi dhe mbarëvajtja e këtij impianti do të jete shembull për vazhdim në vend banimet tjera të komunës. Mirëpo punimet janë kryer me ritëm shumë të ngadalësuar dhe ende nuk kane arritur qe projekti të vihet në funksion.
- **Përmirësimi i rrjetit të furnizimit me rryme elektrike.** Me kompaninë për mirëmbajtjen e rrjetit dhe furnizim me rryme KEDS kemi kontakte të rregullta javore në nivele të drejtorisë dhe Nj.O në Klinë , ndërsa Mujore me Zyrën e Kryetarit dhe Zyrën Regjionale në Pejë. Jemi dakorduar qe të bëjmë punë të përbashkëta në përmirësimin e rrjetit elektrik në fshatra, ndërrimin e shtyllave dhe instalimin e kabllove. Ketë vite kemi investime me shumë në krahasim me vitet paraprake. Vlen të theksohet investimet në riparimin e trafos në Sferkë, Klinë, Zajm, lagjen Arbëria dhe riparimi rrjetit në Caravik, dhe disa linja tjera. Mirëpo kemi kërkesa të shumta nga qytetaret e pothuajse të gjitha fshatrave të cilat presin për tu realizuar.

**Zyra për alarmim informim dhe koordinim,**

Për vitin 2020 si zyrtare e parandalimit nga zjarri pasi qe ishte vit i pandemis dhe me disa kufizime kohore te kohëpas kohshme siç janë vendimet e qeverisë për

zvoglim te stafit apo lirim nga paraqitja ne punë për shkak të moshës apo edhe semundjeve kronike,kotegori kjo ku edhe une kamë qenë e përfshir, i kam realizuar pjeserisht punët dhe dëtyrat sipas planit te parapar vjetor. Zjarret ne përgjithesi kanë shënuar renje shumë te madhe duke krahasuar me vitin paraprak . Inspektimet e kryera dhe realizimi i masave të urdhëruara ndaj subjekteve ka ndiku pozitivisht në renje të zjarreve në krahasim me vitin e kaluar.

Në këtë drejtim edhe gjatë këtij viti janë dhanë disa rekomandimeve adekuate për të respektuar masat parandaluese nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera të mundshme. Janë një sërë masash dhe aktivitetesh që ne i rekomandojmë për të shtuar masat e sigurisë dhe këto masa sigurie duhet të respektohen në bazë të ligjeve ekzistuese. Këtu duhet të përmendim edhe inspektimet për shkaktarët e zjarreve, ku kërkohet mendimi dhe vlerësimi i zyrtarit te parandalimit për bashkëpunim me organet e policisë dhe hetuesisë ku fatmirësisht për vitin 2020 kanë qenë shumë pak . Edhe pse ky vit 2020 është përcjell me temperatura te larta edhe pse ishte pandemi është bërë ngritja e gatishmërisë operacionale të njësisë profesionale zjarrfikëse në Klinë në nivel më të lartë, që me kohë t'iu përgjigjemi ngjarjeve të jashtëzakonshme, të njoftohen për rreziqet dhe masat e sigurisë sidomos gjatë kohës se korrje –fshirjes. Në bashkëpunim me Drejtorin e Bujqësisë dhe Pylltarisë kemi e ndërmarr masa për mbrojte shtesë për sezonin veror 2020. Aktiviteti i Preventivës ndaj zjarrit për vitin 2020 ishte ma i mangët për shkak te pandemisë dhe kufizimeve te kohë pas koheshe siç janë vendimet e Qeveris. Gjatë këtij viti si zyrtar i parandalimit kamë bere raporte mbi vend shikime të zjarreve ku gjatë këtij viti fatmirësisht kanë qen vetëm dy raste djegie te shtëpive. Dalja ne vende te ngjarjes për hulumtimin e shkaqeve te shpërthimit te zjarreve ne bashkëpunim me hetuesit e stacionit policor kemi dal ne vend te ngjarjes për hulumtimin e shkaktarëve te mundshme te shpërthimit te zjarreve, dhe ne te gjitha rastet sipas kërkesës se policisë ne si zyrtare e parandalimit i kemi dhen nga një raport lidhur me shkaktarin e shpërthimit te zjarrit.

. Gjithashtu edhe për ketë vit i kamë kryer të gjitha punët financiare të Drejtorisë Shërbimeve Publike dhe Emergjente, dhe te gjitha drejtorive ne mungesë t e zyrtarit zotues duke filluar nga:

- Zotimin dhe përgatitjen për pagës të **452** lëndëve
- Procedurën e të gjitha pagesave për në Thesar
- Regjistrimin e të gjitha pagesave në mënyrë elektronike
- Kthimin e te kërkesave te kësaj drejtorie ne mënyrë elektronike te cilat ishin **gjithsej: 836.**

## DREJTORIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, gjatë vitit fiskal 2020 ka kryer aktivitet, si në vijim:

- Gjithsejtë kërkesa 1740
    1. Miratuar-1722;
    2. Refuzuar-7;
    3. Pezulluar- 1;
    4. Anuluar-10;
- Puna me palë në zyrë ku dhe kemi dhënë këshilla profesionale, lidhur më zhvillimit e sektorit të bujqësisë;
- Përgatitur planin për mbjelljet pranverore dhe vjeshtore për territorin e Komunës së Klinës;
- Marrë pjesë në mbledhjet e shtabit emergjent, që nga fillimi i pandemisë;
- Gjate 2 mujorit te Karantinës kemi lëshuar 250 leje të qarkullimit për fermerë;
- Monitoruar mbjelljet pranverore dhe vjeshtore;

- Organizuar pesë emisione televizivë Kombëtare dhe tri emisione nëpër radiot lokale, më qëllimin e sensibilizimit të Bujqësisë në Komunën tonë;
- Informuar fermerët rreth garantëve që jepen nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR);
- Caktuar terminë dhe ka pranuar aplikacionet e fermerëve për subvencionimin e grurit, misrit, lopëve, deleve, dhive dhe bletëve, si dhe për subvencionimin e qumështit, për periudhën gjashtë (6) mujore;
- Vizituar gjatë gjithë vitit fermerët në terren, Blegtorët, Bletarët, Perimtarët, Pemëtarët dhe kemi përcjellë gjendjen e të mbjellave vjeshtore dhe pranverore dhe dhënies së këshillave profesionalë për rritjen e rendimentit;

- Përgatitur planin për korrje-shirjeve,
- Bërë kontrollimin e lagështisë dhe rezistencës së grurit gjatë korrje-shirjeve;
- Përgatitur dhe inicimin e procedurave të prokurimit për projektet e drejtorisë së Bujqësisë;
- Kemi kryer punë të tjera administrativë në **DBPZHR.**

**PROJEKTET E PËRFUNDUARA DHE NË VAZHDIM**

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZHR), gjatë vitit 2020 :

- Kemi bërë pastrimin dhe rregullimi e shtratit të lumenjve në qytetin e Klinës, fshatin Jashanicë, si dhe në fshatin Zllakuqan ;
- Kemi filluar me ndërtimin e kanalit të ujitjes në fshatin **Zllakuqan** - Ranovicë;
- Me qellim të ndërtimit të Kanaleve për ujitje kemi zhvilluar procedurat e prokurimit për ndërtimin e kanaleve për ujitje në fshatin Dollovë dhe Stupë, mirëpo për shkak të ankesave të parashtruara nga përfaqësuesit e operatoreve ekonomik të pakënaqur më mos shpërblim më kontratë, nuk ka mundur të filloj me ndërtimin e tyre;
- Kemi mbjellë fidanë të pishave të varrezat e dëshmoreve në fshatin Grabanicë.

Gjatë vitit 2020, më qëllimi të zhvillimit të sektorit të bujqërisë, perimtarisë, pemëtarisë, blegtorisë si dhe të bletarisë, ka mbështetur fermerët e komunës së Klinës :

- Më 54 makina mjelëse;
- Më 13 Moto kultivator;
- Më 70 Spërkatëse Krahu;
- Më 400 koshere komplete (1200 copa);
- Ka hapur 15 puse fermer dhe 3 për shkolla;
- Ka shpërndarë 1200 fidanë të lajthisë.

**NË BASHKËPUNIM ME ORGANIZATËN IADK (Iniciativa për zhvillimin e Bujqësisë), kemi mbështetur pesë fermerëve më kositëse, pijatore, spërkatëse deri në 440 litra, freza, shpërndarëse plehu artificial më kardan.**

**Sektori i Pylltarisë**

**Sektori i pylltarisë gjatë vitit 2020, ka realizuar aktivitetet si në vijim:**

Kemi përgatitur dhe parashtruar 62 fletëparaqitje, në Gjykatën Themelor Pejë – Dega në Klinë :

- 51 fletëparaqitje për dëmtim të pyllit në pronësi shoqërore;
- 1 fletëparaqitjet për dëmtim të pyllit në pronësi private; dhe
- 10 fletëparaqitje për transport dhe shitje ilegale.

- Kemi përgatitur dhe parashtruar 8 kallëzime penale, në Prokurorin Themelore në Pejë;
- Gjatë vitit 2020 dëmi i shkaktuar në pyjet private dhe shoqërore është 150.15 metër kub
    - i arsyetuar me fletëparaqitje 103.51 metër kub;
    - i pa arsyetuar 46.64 metër kub;
- Kemi konfiskuar 24.11 metër kub, janë shitur 10.70 metër kub;

- Kemi përfaqësuar lendet e Drejtorisë së Bujqësisë – sektorit të pylltarisë në 25 seanca gjyqësore të mbajtura në Gjykatën Themelore Pejë – Dega Klinë. Ka pranuar 15 aktvendime nga Gjykata (të gjitha pozitive), më gjithsej 2000.- euro gjoba të shqiptuara;
- Kemi pyllëzuar 5.00 HA sipërfaqe me fidanë të pishave-donacion nga APK-Pejë;
- Gjatë këtij viti në territorin e komunës së Klinës janë djegur 164.70 HA sipërfaqe më pyll;
- Kemi bërë mbi 140 kontrolle në të gjitha rajonet ekonomike pyjore;
- Kemi bërë regjistrimin e demit të shkaktuar gjatë vitit 2020, në pronën shoqërore;

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë vitit 2020 Komuna e Klinës ka realizuar aktivitetin e vet me qellim të përmbushjes së obligimeve për ushtrimin e kompetencave komunale, të cilat adresojnë çështjet e zhvillimit të përgjithshëm të politikave në nivelin lokal dhe që reflektojnë drejtpërsëdrejti në përmasimin e cilësisë së jetesë së qytetarëve. Përgjegjësitë dhe aktivitetet e zhvilluara, njëkohësisht përfshinë edhe obligimet që dalin nga Agjenda Evropiane për Kosovën.

Gjatë vitit 2020 Komuna jonë ka qenë mjaft aktive në ushtrimin e funksioneve, sipas agjendës së planifikuar në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Në periudhën raportuese janar-dhjetor 2020, Komuna në bazë të Planit të veprimit, ka realizuar të gjitha synimet dhe objektivat e planifikuara si :

- Mbajtja e të gjitha seancave të parapara,
- Mbajtja e të seancave të komiteteve obligative,
- Raportimi tremujor, gjashtëmujor. nëntëmujor dhe vjetor lidhur më dokumentet fiskale financiare,
- Raportimi i Kryetarit lidhur më planet zhvillimore dhe investuese dhe raportime tjera sipas kërkesave,
- Miratimi i akteve nënligjore komunale, vendimeve, planeve dhe dokumenteve tjera,
- Ngritja e realizimit të të hyrave komunale,
- Ulja e shpenzimeve për të gjitha kategoritë e mundshme,
- Komuna ka shtuar aktivitetin në bashkëpunimin ndërkomunal,
- Ngritja e cilësisë në shërbime komunale,
- Transparenca dhe llogaridhënia,
- Cilësia në shërbime ndaj qytetarëve ,
- Raportimi dhe angazhimi permanent lidhur më situatënë e pandemisë COVID 19, etj.

Jemi përpjekë që në pika të shkurta t'i përfshijmë të gjitha detyrat dhe obligimet që dalin nga ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi dhe në pajtim më planin e veprimit për vitin 2020.

**K R Y E T A R I:**

**Prof. Dr. Zenun Elezaj**

REPUBLIKA E KOSOVËS • KOMUNA E KLINËS • REPUBLIKA KOSOVA • OPŠTINA KLINA • REPUBLIC OF KOSOVO • MUNICIPALITY OF KLINA